REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE KONTRATAVE

SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 40, Date 22/04/2026

"PER MIRATIMIN E BASHKËORTAKËRISË NËPËRMJET DHURIMIT TË NJË PJESE TË KUOTËS NGA SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR A-CO SH.P.K "

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417,datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 113 pika 1 shkronja b), Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 68,70,71,-104 të Ligjit Nr. 901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"i ndryshuar, nenit 8,9,54 pika 1 germa d) të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e bashkëortakërisë për zotërimin e kuotës në vlerën 26 % të kapitalit themeltar nëpërmjet dhurimit nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar A-CO SHPK me Nipt L62525205G me objekt "Implementimin, ndërtimin,menaxhimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, duke përfshirë energjinë diellore (fotovoltaike) dhe eolike, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë etj"
2. Bashkia Devoll pas pranimit të kuotës do të bëhet zotëruese e 26% të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ligji dhe statuti i shoqërisë.
3. Kjo Shoqëeri do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 901/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
4. Çdo pasuri e luajtshme dhe/ose e paluajthsme në pronësi apo administrim të Bashkisë Devoll që do i vihet Shoqërisë A-CO SHPK në të cilën Bashkia Devoll do të jetë bashkëpronare, për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim, në të gjitha rastet do të miratohet paraprakisht nga Këshilli i Bashkisë Devoll.
5. Asetet që do ti jepen për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim shoqërisë nuk mund të transferohen, nuk mund të tjetërsohen, por mund të përdoren vetëm në interes të projektit duke marrë në çdo rast miratimin e Këshillit Bashkiak
6. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë ose personin e autorizuar prej tij që të nënshkruajë aktet e nevojshme për kuotën dhe ndjekjen e cdo procedure të nevojshme për përfundimin e bashkëortakërisë .

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com